


# Pushteti Lokal dhe Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse



**Përgatiti : Ilir Aliaj**

Maj 2015

## Tabelë Përmbledhëse

- Hyrje
  
- Metodologjia
  
- Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)
  - Çfarë është EITI
  - Parimet
  - Standarti ndërkombëtar
  - Kush përfiton
  - Anëtarësia
  - Struktura
  
- Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri
  - Industria nxjerrëse dhe rëndësia e saj
  - Anëtarësimi i Shqipërisë në EITI
  
- Analiza: Sektori i Industrisë Nxjerrëse dhe Pushteti Lokal
  - Situata Ligjore në Industrinë Nxjerrëse
  - Organizimi i Pushtetit Lokal dhe shpërndarja gjeografike e Industrisë Nxjerrëse
  - Industria nxjerrëse dhe përfitimet e Pushtetit Lokal
  
- Përfundime
  
- Rekomandime
  
- Bibliografia

## I. HYRJE

**Objektivi kryesor** i këtij studimi është analizimi i situatës së Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse dhe Pushtetit Lokal në Shqipëri.

Studimi është i **strukturuar** në kapitujt si më poshtë:

- Hyrje
- Metodologjia
- Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)
- Shqipëria dhe Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse
- Analiza
- Përfundime
- Rekomandime

Në kapitullin *Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)*, trajtohet mënyra se si lindi nisma për transparencë në industrinë nxjerrëse, cilat janë objektivat e saj, parimet kryesore dhe mënyra se si është institucionalizuar kjo nisëm deri tani.

Në kapitullin *Shqipëria dhe Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse*, trajtohet historiku dhe institucionet që ka ndërtuar Shqipëria në vite për të përfaquar këtë nismë, duke u bërë anëtare e saj.

Kapitulli *Analiza* jep një pasqyrë të qartë të mënyrës se si shpërndahet në pushtetin vendor renta minerare, si është bërë ndarja e re territorial dhe çfarë pasojash pozitive dhe negative ka sjellë.

Në kapitullin *Gjetjet* janë përmbledhur të gjitha gjetjet e dala nga analiza që është bërë për përmirësimin e punës

Në kapitullin *Rekomandime* janë përfshirë të gjitha rekomandimet e rëndësishme të cilat kanë dalë nga analiza e situatës së Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse të Shqipërisë, për të përmirësuar punën dhe vecanërisht në ndihmë të forcimit të pushtetit lokal.

## II. METODOLOGJIA

Për të realizuar studimin në përputhje të plotë me objektivat kryesore të tij, u hartua një metodologji e cila do të ndikonte drejtpërdrejtë në cilësinë e studimit.

Për këtë arsye studimi do të kalonte në tre faza kryesore, deri në përfundimin e tij:

- **Faza e parë:** Puna Përgatitore.
- **Faza e dytë:** Analiza
- **Faza e tretë:** Shkrimi i Studimit

Në fazën e parë është:

- hartuar metodologjia e punës
- përcaktuar struktura e studimit
- grumbulluar material kryesor që lidhej drejtpërdrejtë me nismën për transparencë në industrinë nxjerrëse në rang global dhe në Shqipëri.

Në fazën e dytë është:

- mbledhur material ligjor në lidhje me rentën minerare, shpërndarjen e saj, ligji i ri për ndarjen e pushtetit vendor dhe cdo material tjetër ligjor i nevojshëm për të kryer të plotë analizën.
- janë mbledhur të dhëna statistikore nga INSTAT dhe ALBEIT në lidhje me shpërndarjen e rentës minerare në pushtetin vendor.

Në fazën e tretë është:

- bërë përpunimi i të gjitha materialeve të mbledhura
- bërë analiza
- bërë përcaktimi i gjetjeve të konstatuara dhe i rekomandimeve që propozohen për t'i ardhur në ndihmë përmirësimit dhe forcimit të rolit të pushtetit vendor në lidhje me problemet që adreson industria nxjerrëse në Shqipëri.

### III. Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)

#### 1. Cfarë është EITI?

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse është lancuar për herë të parë në Samitin Botëror të Qëndrueshmërisë së Zhvillimit në Johannesburg, në shtator të vitit 2002 nga kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar z. Toni Blair.

Ideja për të ndërmarrë një iniciativë të tillë diskutohej tashmë prej kohësh në të gjitha qarqet akademike, të shoqërisë civile dhe të kompanive, të cilat shpesh i shqetësonte pyetja, përse vënde me pasuri të mëdha nëntokësore janë kaq të varfëra? Ku shkojnë të ardhurat që shteti përfiton nga shfrytëzimi i këtyre pasurive?

Për t'i dhënë përgjigje pyetjeve u pa qartazi nevoja për të ndërmarrë një iniciativë të re, e cila do të lidhej drejtpërdrejtë me detyrimin e qeverive për të bërë transparencë për mënyrën e përdorimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave që siguroheshin nga shfrytëzimi i pasurive nëntokësore, pronë e publikut.

Kështu, iniciativa e ndërmarrë në shtator të vitit 2002, u konkretizua dhe u institucionalizua në vitin 2003, në Londër, në konferencën e 1- të ndërkombëtare me pjesëmarrjen e 140 delegatëve, përfaqësues nga qeveritë, shoqëria civile dhe kompanitë e shfrytëzimit të pasurive nëntokësore. Në këtë konferencë u hodhën bazat kryesore dhe u hartuan 12 principet bazë mbi të cilën do të funksiononte kjo nisëm për rritjen e transparencës mbi pagesat dhe të ardhurat që siguronte industria nxjerrëse.

Në mars të vitit 2005, në Londër, u mbajt Konferenca e dytë e EITI, ku mbështetur në 12 principet e miratuara në konferencën e parë në vitin 2003, u hartuan 6 kriteret kryesore që duhet të plotësonin vendet për të qënë anëtare të Nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse (EITI). Dhe njëkohësisht u ngrit edhe një grup këshillimor ndërkombëtar, i cili kishte për detyrë përgatitjen e guidës për mënyrën se si do të punonte dhe do të funksiononte kjo nisëm, e cila tashmë dukej qartazi që kishte tërhequr vëmendjen e shumë organizatave të shoqërisë civile, të Bankës Botërore, të Fondit Ndërkombëtar Monetar etj.

Në tetor të vitit 2006, në Oslo, u mbajt konferenca e 3 ndërkombëtare e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Në këtë konferencë, me propozim të grupit këshillimor ndërkombëtar u krijua Bordi me shumë pjesëmarrës nga shoqëria civile dhe kompanitë, si edhe u krijua si një ent i pavarur, Sekretariati i EITI, i cili do të kishte selinë në Oslo.

Në mars të vitit 2011, në konferencën e 5 –të të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, u bë rifreskimi i bordit duke u zgjedhur kryetari i ri dhe anëtarë të rinj dhe njëkohësisht u miratua edhe një set me 23 kritere, të cilat tashmë njihen me emrin Rregullat e EITI.

Në maj të vitit 2013, si rrjedhim i përmirësimit të punës, i nevojave dhe ndryshimeve të vazhdueshme që janë bërë në drejtim të përmirësimit të standarteve të transparencës për këtë nisëm, rregullat e EITI u zëvendësuan me standartet e EITI.

***Pra në përfundim mund të themi që Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse është një standart ndërkombëtar për të promovuar menaxhimin e hapur dhe të ndërgjegjshëm të burimeve natyrore.***

Kjo nisëm ka për **qëllim të** forcojë sistemet e qeverive dhe të kompanive, të ndezi debatin publik dhe të pasqyrojë të vërtetën.

**Objektivat** kryesor të kësaj nisme janë:

- a. zhvillimi dhe implementimi i një mekanizmi për të bërë të mundur deklarimin e të ardhurave që mbliidhen nëpërmjet industrive nxjerrëse nga përdorimi i burimeve natyrore,
- b. publikimi i këtyre të dhënave në një format të kuptueshëm nga të gjithë
- c. mbikqyrja e tyre në mënyrë që t'i mundësoje publikut të gjërë të ketë informacion përse i përket të ardhurave dhe shpenzimeve publike,
- d. krijimi i mekanizmave për mirëadministrim e këtyre të ardhurave në dobi të komuniteteve.

Në cdo vend kjo nisëm, përfshirë edhe Shqipërinë si një vend anëtar, mbështetet nga një koalicion bashkëpunues midis qeverisë, shoqërisë civile dhe kompanive.

## 2. Cilat janë parimet e EITI?

Parimet e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse janë guri i themelit mbi të cilën u lancua dhe vazhdon aktivitetin e saj kjo Nismë. Parimet përmbliohen në:

- a. **Besimin** se përdorimi i kujdesshëm i burimeve natyrore kontribuon në rritjen ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë në vendet e pasura me burime natyrore.
- b. **Pohimin** se menaxhimi i pasurive natyrore në dobi të qytetarëve është një e drejtë e ushtrimit të kompetencave të qeverisë në interes të zhvillimit të vendit të tyre.
- c. **Besimin** se njohja e të ardhurave dhe e shpenzimeve, nga ana e publikut, mund të ndihmojë në zhvillimin e debatit publik dhe të japë zgjidhje dhe opinione konkrete për qëndrueshmërinë e zhvillimit.
- d. **Nënvijëzimin** se transparenca nga ana e qeverisë dhe e kompanive të shfrytëzimit të industrisë nxjerrëse shërben për të rritur më tej menaxhimin e përgjegjshëm të financave publike.
- e. **Dijenin** se rritja më shumë e transparencës mund të bëhet në kontekstin e respektimit të kontratave dhe ligjeve.
- f. **Dijenin** se investimet e drejtpërdrejta, vendase apo të huaja, në rritje të vazhdueshme për mjedisin, bëjnë të mundur rritjen e transparencës.
- g. **Besimin** se qeveritë janë të përgjegjshme si në princip ashtu edhe në praktikë për t'u kujdesur për mbledhjen e të ardhurave nga industria nxjerrëse dhe për shpenzimin e tyre në mënyrën e duhur.
- h. **Përkushtimin** për të inkurajuar standarte të larta të transparencës dhe të ndërgjegjes së publikut, të operacioneve qeveritare dhe të kompanive.
- i. **Besimin** se është e nevojshme krijimi i një baze të gjerë të dhënash ku të jenë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet nga industria nxjerrëse, lehtësisht e përdorshme nga publiku i gjerë.
- j. **Besimin** se në bërjen publike të pagesave ndaj qeverisë duhet të përfshihen të gjitha kompanitë që operojnë në fushën e industrisë nxjerrëse.
- k. **Besimin** se thelbi për të ecur në rrugën e duhur në këtë iniciativë është roli i rëndësishëm dhe bashkëpunues i të gjithë aktorëve (qeveria, shoqëria civile, kompanitë).

### 3. Çfarë është standarti EITI?

**Standarti EITI**, nënkupton vendosjen dhe mbikqyrjen e transparencës në industrinë nxjerrëse të burimeve natyrore, duke ndihmuar që të ardhurat nga ky biznes të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e vendit.

Mjeti me të cilin EITI ushtron mbikqyrjen e transparencës janë raportet vjetore që përgatiten për cdo vend anëtar apo kandidat , nga administratori i pavarur. Këto raporte, në funksion të transparencës, monitorojnë të ardhurat e kompanive që operojnë në sektorin nxjerrës, si dhe pagesat që vetë kompanitë e shfrytëzimit të burimeve natyrore derdhin në favor të institucioneve shtetërore, të cilat konsiderohen të ardhura për shtetin. Raporti vjetor EITI bëhet publik për të gjithë.

EITI ka një metodologji fleksibël që siguron një standart global të qëndrueshëm për të gjithë vendet zbatuese. Rregullat EITI përcaktojnë metodologjinë që vendet duhet të ndjekin për t'u bërë anëtarë të EITI-t.

### 4. Si anëtarësohesh në EITI?

Cdo vend i cili ka pasuri nëntokësore dhe zhvillon industrinë nxjerrëse ka të drejtë, duke plotësuar kriteret e vendosura nga EITI, të bëhet anëtar i kësaj Nisme.

Përpara anëtarësimit cdo vend duhet të ndjekë hap pas hapi 4 shkallë:

- **Shkalla 1** – nënshkrimi i marrëveshjes me qeverinë
- **Shkalla 2** – hartimi i një plani pune që përcakton objektivat se pse ky vend kërkon të hyjë në EITI
- **Shkalla 3** – krijimi i një grupi me përfaqësues nga shoqëria civile, qeveria dhe kompanitë (MSG)
- **Shkalla 4** – krijimi i sekretariatit vendor



Pranimi si anëtar në EITI kalon në dy faza:

1. Në fazën e parë, ti je vend **kandidat** dhe ke shprehur gadishmërinë për të respektuar të gjitha standartet e vendosura nga EITI, je pranuar nga bordi.
2. Në fazën e dytë, të është dhënë një afat kohor prej 1 – 1,5 vjet për të të mbikqyrur nëse ke vullnetin për të plotësuar kërkesat e detajuara të standarteve të EITI. Nëse raporti i bordit të vlerëson “kalueshëm” atëherë ti bëhesh **anëtar**.

Anëtarësimi nuk është një e drejtë e përjetshme por një detyrim, i cili duhet të mbahet dhe të punohet për të qënë gjatë gjithë kohës në koherencë me standartet e EITI.

Deri tani janë 48 vende anëtare të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, përfshirë edhe Shqipërinë, janë 17 vende të cilat mbajnë titullin vende kandidate.

#### 5. Çfarë përfitohet nga EITI ?

**Përfitimet për vendet zbatuese** përfshijnë një klimë të përmirësuar të investimeve, duke siguruar një sinjal të qartë për investitorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare se qeveria është e angazhuar për një transparencë më të madhe. EITI gjithashtu ndihmon në forcimin e përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë, si dhe të promovojë stabilitet më të madh ekonomik dhe politik. Kjo, nga ana tjetër, mund të kontribuojë në parandalimin e konfliktit bazuar në sektorët e naftës , minierave dhe gazit.

**Përfitimet për kompanitë dhe investitorët** përqëndrohen në zbutjen e rreziqeve politike dhe reputacionit. Paqëndrueshmëria politike e shkaktuar nga një qeverisje “e keqe” është një kërcënim i qartë për investimet. Në industrinë nxjerrëse, ku investimet janë intensive për nga ana e kapitalit dhe natyrisht në mënyrë që të gjenerojnë fitime kanë nevojë për një stabilitet afatgjatë. Reduktimi i paqëndrueshmërisë është në dobi të biznesit. Nga ana tjetër transparenca e pagesave të bëra për një qeveri mund të ndihmojnë gjithashtu për të demonstruar kontributin që investimi i tyre bën në një vend.

**Përfitimet për shoqërinë civile** vijnë nga rritja e sasisë së informacionit në fushën publike për ato të ardhura që qeveritë menaxhojnë në emër të qytetarëve, duke e bërë qeverinë më të përgjegjshme.

## 6. Cila është struktura e EITI?

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse funksionon mbi bazën e 3 institucioneve:

1. *Takimi i anëtarëve*

2. *Bordi i EITI*

3. *Sekretariati Ndërkombëtar*

1. **Takimi i anëtarëve**, realizohet gjatë konferencave ndërkombëtare të cilat mbahen një herë në 3 vjet.
2. **Bordi i EITI**, është organi ekzekutiv, i cili mbledhet 3 herë në vit dhe përfshin aktorë të ndryshëm si: shoqëria civile, kompanitë, qeveria, individë etj
3. **Sekretariati**, me seli në Oslo, është përgjegjës për të kthyer në veprime të gjitha vendimet që merren nga bordi i EITI dhe për koordinimin ndërkombëtar të implementimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

## IV. Shqipëria dhe Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse

### 1. Cila është rëndësia e industrisë nxjerrëse?

Shqipëria është një vend me pasuri të mëdha naftë dhe burime minerare, ku si rrjedhim industria nxjerrëse gjithmonë ka qënë një sektor, i cili ka tërhequr vëmendjen e investitorëve vendas dhe të huaj.

Kërkimi, zbulimi, shfrytëzimi dhe përpunimi i pasurive nëntokësore, përbën një ndër komponentët më të rëndësishëm të ekonomisë Shqiptare. Për shumë kohë industria nxjerrëse ka qënë një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Ky sektor përfaqësohet nga sektori industrial i naftës dhe sektori minerar. Ky i fundit është i përqëndruar kryesisht në prodhimin e kromit, bakrit, hekur nikel, bitum, zhavorre bituminoze e minerare të tjera që shërbejnë si lëndë e parë në industrinë e ndërtimit.

Deri në vitet 80-të të shekullit të kaluar, Shqipëria ishte një nga prodhuesit më të mëdhenj të kromit në botë, si edhe të nikelit, hekurit dhe mineralizimit të bakrit, e cila kulmoi në vitin 1989 ku prodhimi dhe eksporti kapën vlerën prej 140 milion dollarë amerikanë e përkthyer ndryshe, kapnin 80% të eksporteve<sup>1</sup>. Ndërsa e kundërta ndodhi në sektorin e prodhimit të naftës, ku pika kulmore e saj ishte viti 1975 dhe vjen duke u ulur deri në vitin 1982 për shkak të mungesës së fondeve për kërkim në fushë dhe për ekspertizë teknike.

Në vitet 90-të të shekullit të kaluar u pa një lëvizje rëstrukturuese drejt privatizimit, qeveritë bënë përpjekje për të tërhequr investitor të huaj, pas kolapsit ekonomik socialist. Në vitin 1994 u krijua hapësira ligjore për të bërë të mundur transferimin e veprimeve (prodhimit) nga shteti drejt investitorëve cilësor, gjë e cila nuk u realizua me sukses. Në vitin 1998 qeveria ndër morri në mënyrë të menjëhershme një proces transferimi të licensave, për t'ia kaluar të drejtat e zbulimit dhe shfrytëzimit minerar individëve, proces i cili dështoi për shkak të mungesës së ekspertizës dhe të investitorëve të fuqishëm<sup>2</sup>.

Në dekadën e fundit, qeveria i ka dhënë license shpimi një numri të madh kompanish të huaja, eksperte në fushë dhe financiarisht të shëndetshme, sic janë kompani austriake, kanadeze, amerikane, kroate, greke, suedez etj. Kjo ka sjellë një rritje të fuqisë punëtore, një fluks të investimeve në këtë sektor, gjë e cila sjell optimizëm për një rimëkëmbje afatgjatë të këtij sektori<sup>3</sup>.

---

<sup>1</sup> Raporti i Bankes Boterore 2009

<sup>2</sup> Raporti i Validimit 2011

<sup>3</sup> Raporti i Validimit 2011

Sipas të dhënave të INSTAT, kontributi i kësaj industrie në Prodhimin e Përgjithshëm Bruto (PPB) ka qënë :

Tab.1

	<b>PPB (%)</b>	<b>Të ardhurat në buxhet (%)</b>	<b>Eksportet(%)</b>
<b>Viti 2011</b>	4,3	1,8	25
<b>Viti 2012</b>	5,6	2,5	32

Sic shihet nga viti 2011 në vitin 2012, ka një rritje përsa i takon kontributit të industrisë nxjerrëse në ekonominë e vendit, por përsëri kjo është në një nivel jo të kënaqshëm.

Gjatë vitit 2012 industria nxjerrëse ka sjellë të ardhura për ekonominë shqiptare 65, 853 milion leke. Po ta ndajmë sipas sektorëve brenda industrisë nxjerrëse kemi të ardhura nga hidrokarburet në shumën 50,333 milion lek, ndërsa minierat kanë kontribuar me 15,517 milion leke. E shprehur me përqindje kemi 76 përqind kontribut nga sektori i hidrokarbureve dhe vetëm 24 përqind nga ai mineral.

Në vitin 2011-të raportohen rreth 752 leje minerare, por vetëm 57 prej tyre kontribuojnë me 71.8% të vlerës së prodhimit nga sektori mineral dhe rreth 71.4% të sasisë totale të parasë të gjeneruar nga sektori mineral. Pjesa tjetër e të licencuarve kanë aktivitet thuajse të papërfillshëm ekonomik<sup>4</sup>.

Raporti i EITI 2011 merr në konsideratë deklaratimet e 67 kompanive më të mëdha operatore në sektorin e naftës, gazit dhe atë minerare ku cilesohet: “Sipas raportit të ri që do të publikojmë, 10 korporatat e mëdha të naftës dhe të gazit paguajnë rreth 80 përqind të kontributit total të këtyre subjekteve në buxhetin e shtetit, ndërsa 57 kompanitë e tjera paguajnë pjesën e mbetur (20%)”.

## *2. Anëtarësimi i Shqipërisë në EITI*

Qeveria Shqiptare, duke patur si prioritet të saj, transparencën dhe luftën kundër korrupsionit, vlerësoi shumë të rëndësishme anëtarësimin e Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

<sup>4</sup> Raporti vjetor i EITI për vitin 2011

Në kushtet kur sektori i industrisë nxjerrëse është një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë së vendit, në muajin Mars të vitit 2009-të, nëpërmjet një letre nga ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, u aplikua për statusin e vendit kandidat në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, i cili u aprovua në maj të vitit 2009.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 540 Datë 07.07.2010 “Për Ngritjen dhe funksionimin e sekretariatit, për ndjekjen e procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues, në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), u krijua Sekretariati Shqiptar i EITI ( i njohur si Albeiti) .

**Sekretariati Shqiptar i EITI (ALBEITI)** e ka selinë në Tiranë dhe misioni i tij sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave të përmendur më lartë është :

“ Realizimi i të gjitha hapave të anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues , në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) dhe, pas këtij anëtarësimi, përgatitjen e raporteve vjetore si vend zbatues i kësaj nisme, në bashkëpunim me grupin ndërinstitucional të punës të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse”.

Me Urdhër të Kryeministrit Nr. 71, datë 21.07.2011 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen e procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)” u krijua **Grupi Ndërinstitucional i Punës** me 16 anëtarë.

Grupi Ndërinstitucional i Punës përbëhet nga :

- 5 përfaqësues të shoqërisë civile,
- 5 përfaqësues nga kompanitë që operojnë në sektorin e industrisë nxjerrëse
- 6 përfaqësues nga Ministria dhe entet qeveritare përgjegjëse të këtij sektori.

Grupi Ndërinstitucional i Punës udhëhiqet nga zv. Ministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, i ngarkuar për zbatimin dhe mbikëqyrjen e kësaj nisme në Shqipëri.

Për herë të parë është publikur në muajin Prill 2011-të, Raporti Vjetor i pagesave në industrinë nxjerrëse për vitin fiskal 2009-te. Nga raporti rezulton se ka diskordanca të parëndësishme ndërmjet pagesave të kompanive dhe të ardhurave të deklaruara nga shteti.

Në Gusht të vitit 2011-të u publikua raporti i Validimit mbi implementimin e EITI në Shqipëri.

Në Qershor të vitit 2012 –te Shqipëria përgatiti raportin e dytë të pagesave për vitin fiskal 2010- të.

Së fundmi, më 2 maj te vitit 2013 -të, Bordi Ndërkombëtar EITI, e shpalli Shqipërinë vend anëtar në përputhje me standartet EITI. Përputhja me standartet EITI do të thotë se vendi ka një proces efektiv për deklarimin vjetor dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave, të cilat vijnë nga sektori i industrisë nxjerrëse. Ky proces u lejon qytetarëve të shohin se sa të ardhura merr vendi i tyre nga kompanitë e naftës, gazit dhe minierave.

Tashmë, Shqipëria është në sfidën e vazhdueshme për të qëndruar gjithmonë përkrahë vëndeve anëtare të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, për të respektuar dhe zbatuar në mënyrë konsistente të gjitha parimet dhe standartet që ofron EITI.

## V. Analiza: Sektori i Industrisë Nxjerrëse dhe Pushteti Lokal

### 1. Situata ligjore në sektorin e industrisë nxjerrëse

Industria Nxjerrëse, si një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomik të vendit, mbas vitit 1990, u prek shumë nga ndryshimet e sistemit ekonomik që pësoi në ato vite Shqipëria, siç ndodhi me të gjitha degët e ekonomisë. Këto ndryshime diktuan nevojën emergjente për ndryshime në fushën e legjislacionit, si një mjet rregullator për mënyrën e menaxhimit dhe të perspektivës së këtij sektori.

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në kuadrin ligjor mbi të cilin mbështetet menaxhimi i burimeve natyrore, është specifikisht e përcaktuar se pronari i vetëm i të gjitha pasurive nëntokësore, mbi tokësore, detare dhe nëndetare është shteti shqiptar dhe kjo është një e drejtë e pa tjetërsueshme e tij.

Sipas kuadrit ligjor, mbi bazën e të cilit rregullohet menaxhimi i burimeve natyrore, institucionet kompetente të cilat merren me menaxhimin janë:

- **Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI)**, është institucioni qendror përgjegjës për hartimin e politikave publike ( strategjitë, përparësitë e zhvillimit, programet e veprimeve dhe të administrimit të burimeve natyrore, planet vjetore etj) , për menaxhimin e burimeve natyrore, për monitorimin e zbatimit të këtyre politikave, për miratimin e dhënies së liçensave të kërkimit e prodhimit të naftës, gazit dhe minerareve.
- **Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)**, është institucioni në vartësi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe mbështet këtë të fundit , në procedurat e para liçensimit për prodhimin (duke promovuar zonat e pashfrytëzuara, duke udhëzuar subjektet e interesuara për mënyrën e procedimit, verifikimin e planit teknik të propozuar, negocimin e planit të investimeve etj), si edhe në procedurat e pas liçensimit duke monitoruar aktivitetin e të liçensuarve nëpërmjet vetëdeklarimit të tyre apo në terren.
- **Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)**, është institucioni në vartësi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe mbështet këtë të fundit, në procedurat e para liçensimit për kërkimin (duke promovuar zonat e pashfrytëzuara, duke udhëzuar subjektet e interesuara për mënyrën e procedimit, verifikimin e planit

technik të propozuar, negocimin e planit të investimeve etj), si edhe në procedurat e pas liçensimit duke monitoruar aktivitetin e të liçensuarve nëpërmjet vetëdeklarimit të tyre apo në terren.

Industria nxjerrëse, është e ndarë në dy sektorë të rëndësishëm, të cilët për shkak të specifikave që kanë në fushat e tyre rregullohen nga ligje të ndryshme. Kështu kjo industri ndahet në:

**1. Sektori i industrisë minerare,** i cili pas një periudhe tranzicioni më shumë probleme, rregullohet, tashmë, nëpërmjet Ligjit Nr. 10304, datë 1.07.2010 “ Mbi Sektorin Minerar në Shqipëri” . Ky ligj ka si objektiv kryesor nxitjen e veprimtarisë minerare nëpërmjet transparencës dhe konkurrencës së lirë, nga njëra anë dhe nga ana tjetër rritjen maksimale të perfitimit publik, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik nga rreziku minerar dhe i mbetjeve të industrisë nxjerrëse.

Liçensimi në sektorin minerar bëhet nga Qendra Kombëtare e Liçensimit me miratimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Ka dy lloj liçensash:

- Liçensë shfrytëzimit për prodhim që jepet me afat fillestar 25 vjet, me të drejtë rinovimi 10 vjet.
- Liçensë kërkimore me afat fillestar 3 vjet me të drejtë rinovimi.

Liçensimi në sektorin minerar mund të bëhet edhe me koncension në bazë të ligjit “Për Koncensionet”, ku janë përcaktuar procedurat e nevojshme.

*Kushtet e detajuara të kontratave të koncensionit nuk bëhen publike për shkak të sekretit tregtar dhe si rrjedhim nuk janë të aksesueshme nga publiku.*

**2.Sektori i naftës dhe i gazit,** i cili rregullohet nga ligji Nr. 31/ 2012 “Për Hidrokarburet”. Ky sektor ka një specifikë në rregullimin ligjor të tij mbasi në Mars të vitit 1993, shteti, krijoi shoqërinë anonime “ALBPETROL” me kapital 100% shtetëror, i cili vepronte në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe të gazit natyror. ALBPETROL sh.a ka nën administrimin e tij të gjitha fushat naftëmbajtëse në Shqipëri dhe të gjitha blloqet e kërkimit, siç janë blloqet 1,5,6,7,8, zona e Dumresë, Panajës, Velçës dhe Delvinës.



Në vitin 1998, si rrjedhim i ristrukturimit të ALBPETROL sh.a u nda në 3 shoqëri:

- ALBAPETROL sh.a, e cila ruajti të drejtën e aktivitetit të kërkimit dhe prodhimit të naftës e gazit dhe administron të gjitha liçensat e dhëna para ristrukturimit
- ARMO sh.a, e cila mbajti rafinimin dhe marketingun e shitjes së naftës dhe gazit
- SERVCOM, e cila morri shërbimet e naftës

Ligji i ri i Hidrokarbureve, miratuar në vitin 2012 i lejoi shoqërisë ALBPETROL sh.a të drejtën për të transferuar të drejtat në kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit, duke nën-liçensuar shoqëri të interesuara dhe të specializuara në fushën e naftës dhe gazit, por gjithmonë me miratimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

Gjithashtu, në sektorin e Hidrokarbureve, shteti i përfaqësuar në këtë rast nga ALBPETROL sh.a, rregullon çmimin e shitjes së hidrokarbureve nëpërmjet urdheresave të miratuara nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, çmime mbi bazën e të cilit fillon ankandi.

Marrëveshjet e hidrokarbureve, lidhen kryesisht për një periudhë kohe 25 vjet me të drëjte shtyrje jo më shumë se 10 vjet. Palë në këto marrëveshje është: - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), por në rastet kur marreveshja ju referohet të drejtave dhe zonave të kërkim - prodhimit që janë nën administrimin e ALBPETROL sh.a, atëherë edhe ky i fundit bëhet palë në to.

*Marrëveshjet e hidrokarbureve dhe kushtet specifike të tyre nuk janë publike mbasi konsiderohen si sekret tregtar dhe si rrjedhim nuk janë të aksesueshme nga publiku.*

Në kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, në ligjin e ri Nr. 10304, datë 1.07.2010 “Mbi Sektorin Minerar në Shqipëri” në nenin 36, është bërë e detyrueshme raportimi në formatin e kërkuar të të dhënave financiare, sipas standartit EITI, për subjektet e liçensuara në fushën e kërkimit dhe prodhimit të minerareve. Ndërsa të liçensuarit në fushën e hidrokarbureve e bëjnë këtë mbi baza të vullnetarizmit pa qenë ligjërisht të detyruar, *për këtë arsye bëhet më e vështirë marrja e informacioneve të nevojshme në lidhje me transparancën në sektorin e hidrokarbureve.*

Struktura e të ardhurave që siguron shteti nga sektori i industrisë nxjerrëse, në bazë të kuadrit ligjor në fuqi është si më poshtë:

- a. Renta minerare paguhet nga subjektet e liçensuara për shfrytëzimin e burimeve natyrore. Ky detyrim mbliidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në rastet e eksportit dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për shitjet brenda vendit.

- b. Tatim mbi fitimin, që llogaritet si përqindje mbi të ardhurat neto të shoqërisë. Ky detyrim mbliidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- c. Bonuset e nënshkrimit janë terma tipike të marrëveshjeve të hidrokarbureve dhe përcaktohen sipas negociatave në momentin e dhënies së lejes të kërkimit apo prodhimit. Ky detyrim mbliidhet nga ALBPETROL sh.a për prodhimin dhe AKBN për kërkimin.
- d. Ndarja e prodhimit të naftës, është detyrimi që kanë subjektet e nën licensuara nga ALBPETROL sh.a për t'i dhënë kësaj kompanie për prodhimin ekzistues 65-75% dhe 1-5% nga prodhimi vetjak. Kjo jepet në vlerë monetare ose në natyrë.
- e. Interesat e shtetit në industrinë nxjerrëse, është detyrim i cili lidhet me përfitimin nga ndarja e dividendit të shoqërisë ALBPETROL sh.a, apo në rast privatizimi të tij.

## 2. Organizimi i Pushteti Lokal dhe Shtrirja Gjeografike e Industrisë Nxjerrëse

Historia e organizimit të pushtetit lokal i ka themelet hershëm që nga shpallja e pavarësisë në 28 Nëntor 1912. Në 22 Nëntor 1913, nëpërmjet ligjit “Kanuni i përshtatshëm i Administratës Civile në Shqipëri”, ndarja administrative ishte në bazë prefekturash të drejtuara nga prefekti, nënprefekturat e drejtuara nga nënprefektët dhe krahinat të drejtuara nga krahinorët. Gjithsej ishin 8 prefektura.

Midis viteve 1921 deri në vitin 1945, ndarja administrative e Shqipërisë u rregullua fillimisht nëpërmjet “Ligjit organik të bashkive” dhe më vonë edhe nëpërmjet Kodit Civil të miratuar në vitin 1928. Njësia fillestare ishte fshati, i cili drejtohej nga kryeplaku dhe zgjidhej nga mbledhja e fshatit, Bashkia me popullsi mbi 200 familje që drejtohej nga kryebashkiaku dhe këshilli bashkiak të zgjedhur nga populli. Komuna, si njësi administrative përfshinte disa fshatra dhe drejtohej nga kryetari dhe këshilli i komunës. Më pas hyri edhe koncepti i prefekturës si njësi administrative më e madhe, e cila drejtohej nga prefekti i emëruar nga Ministri. Në vitin 1940 Shqipëria nga pikëpamja e ndarjes territoriale kishte: 10 prefektura, 30 nënprefektura, 23 bashki, 136 komuna dhe 2551 fshatra.

Pas vitit 1945, ndarja territoriale e Shqipërisë, pësoi ndryshime të vazhdueshme në përputhje të plotë me linjën ekonomike dhe politike që po ndiqej në atë kohë nga qeveria në pushtet. Kështu në vite, termi prefekturë u zëvendësua me termin qark dhe ky i fundit me termin rreth. Termi komunë u zëvendësua me termin fshat apo fshat i bashkuar. Krahas këtyre ndarjeve filluan të funksiononin edhe këshillat popullor për të gjitha njësitet administrative (rreth, lokalitet, fshat, fshat i bashkuar) të cilët zgjidheshin nga populli me rrotacion cdo 3 vjet. Në vitin 1990 darja administrative e Shqipërisë ishte : 26 rrethe, 539 fshatra të bashkuara, 2848 fshatra, 67 qytete dhe 306 lagje.

Në vitin 1992, në bazë të nenit 1, të ligjit nr.7572, datë 10.06.1992 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Pushtetit Lokal ” Këshilli i Ministrave në Qershor 1992, bëri ndryshime në ndarjen aktuale administrativo-territoriale të Shqipërisë të diktuar nga nevoja që sollën ndryshimet sociale dhe ekonomike në vendin tonë. Kështu, me ndarjen e re territorial në vitin 1992 Shqipëria numëronte 36 *rrethe*, 44 *bashki* dhe 313 *komuna*. Në nivel rrethi, bashkie dhe komune u ngritën *këshillat lokalë* me të zgjedhur nga populli dhe *kryetarët e bashkive dhe komunave* si organ ekzekutiv të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.

Më pas, në bazë të ligjit nr.7608, date 22.09.1992 “ Për Prefekturat ” u krijuan edhe 12 *prefektura* si njësi që drejtohen nga *prefekti* i emëruar nga Këshilli i Ministrave. Çdo prefekturë përfshinte 2 - 4 rrethe. Në vitin 2000 me ligjin nr.8653, datë 31.07.2000 u suprimuan rrethet si njësi administrative dhe u krijuan *qarqet*. Nga viti 2000 deri në vitin 2014, janë bërë disa ndryshime të pjesshme në ndarjen administrativo-territoriale pa ndryshime të rëndësishme strukturore dhe Shqipëria është e ndarë administrativisht, deri në vitin **2014, në: 12 qarqe, 65 bashki dhe 309 komuna.**

Në mbështetje të direktivave të dhëna në Progresraportin e Komisionit European për vitin 2012-2013, Shqipëria nisi reformën administrativo-territoriale. Kjo reformë synonte shmangien e fragmentizimit territorial dhe administrativ, forcimin dhe krijimin e njësive të qeverisjes vendore më të mëdha dhe më efikase për të ofruar një shërbim më cilësor dhe staf më të kualifikuar. Kështu është suprimuar koncepti i njësisë administrative të rrethit dhe të komunës. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore tashmë quhen Bashki, ndërsa nëndarjet brenda bashkive quhen njësi administrative të cilat do të ruajnë kufijtë e tyre ekzistues dhe do të ofrojnë shërbime administrative për popullatën e tyre.

Kjo reformë u finalizua me miratimin e ri të ligjit nr. 115 datë 2014 “Për ndarjen Administrativo - Territoriale të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”. Me ligjin e ri tashmë Shqipëria është e ndarë nga pikëpamja territoriale dhe administrative në **12 qarqe dhe 61 bashki. (Fig. 1)**



Reforma territoriale –administrative në Shqipëri, si në të gjithë sektorët e tjerë ka një impakt të rëndësishëm edhe në menaxhimin e industrisë nxjerrëse.

Kështu, territori i Republikës së Shqipërisë është mjaft i pasur me burime natyrore siç janë mineraret dhe hidrokarburet . Zonat me prodhimin më të madh të minerareve është zona e Bulqizës, ndërsa me prodhimin më të madh të hidrokarbureve është zona e Patos Marinzës.

Industria nxjerrëse sipas specifikave të saj është e shpërndarë sipas zonave me poshtë:

#### **Mineraret** përfshijnë zonat:

- *Minerali i kromit*: rezerva të provuara 36.9 milion ton, i cili është i përqëndruar në Tropojë, Kukës, Bulqizë dhe Shebenik (Pogradec)
- *Minerali i bakrit*; rezerva e provuar është 53 milion ton, i cili është i përqëndruar në Munella, Qaf Bari, Tuç, Spaç, Derven, Kurbnesh, Golaj dhe Thirraj.
- *Minerali i Hekur Nikel* shtrihet në zonën e Devollit me rezerva të provuara 150 milion ton ( Bilisht, Bitinckë), Pogradec (Guri i Kuq, Cervenake), Librazhd, Prrenjasi, Skroska, Xixillas, Bushtrice), Kukes (Namez, Trull Suroj, Nome)
- *Minerali i qymyrit* rezerva të provuara janë 794 milion ton. Shtrihet në zonën e Tiranës (86% të rezervave), Korçë-Pogradec (10%) dhe Memaliaj (4%)

#### **Hidrokarburet** gjenden:

- *Fushat naftë mbajtëse* janë : Drashovica, Patosi, Kucova, Marinza, Visoka, Gorisht - Kocul, Ballsh-Hekal, Cakran - Mollaj, Finiq - Krane, Delvina, Divjaka, Sqepuri.
- *Gazi natyror* : gjendet në Ballaj - Kryevidh, Frakulla, Povelca, Panaja, Ad-4 (në det) .

Zhvillimi i industrisë nxjerrëse është pazgjidhshmërisht i lidhur edhe me zhvillimin ekonomik dhe social të zonës ku ai zhvillohet. Reforma e re territoriale, duke patur për qëllim krijimin e njësive të qeverisjes vendore të mëdha në mënyrë që të zhduk pabarazinë midis zhvillimeve ekonomike të njësive më të vogla vendore, krijon vështirësi në shpërndarjen e drejtë të të ardhurave që vijnë nga renta minerare. Deri tani nuk ka asnjë procedurë se si të ardhurat do të ndahen brenda për brenda këtyre njësive, p.sh në një njësi vetëm njëra pjesë ka burime natyrore dhe përfitimet nga renta minerare duhet ti shkojnë komunitetit ku zhvillohet industria nxjerrëse, por me situatën që kemi kjo nuk është e shprehur qartësisht në ligj.

Megjithëse, janë dhënë një numër i madh liçensash për zhvillimin e industrisë nxjerrëse si minerare ashtu edhe për hidrokarburet, nuk është parë në gjithë këto vite një plan zhvillimor i komunitetit ku zhvillohet kjo industri, nuk kemi një ndërhyrje të pushtetit vendor në përmiresimin e kushteve të jetesës, në rritjen e punësimit, në rritjen e cilësisë së arsimimit, në zhvillimin e arsimit profesional etj.

### *3. Industria Nxjerrëse dhe përfitimet e Pushtetit Lokal*

Një nga elementet më të rëndësishëm të standartit të transparencës në industrinë nxjerrëse është pikërisht mënyra dhe sasia e fondeve që shkojnë pranë komunitetit ku zhvillohet industria nxjerrëse për të rikompensuar dëmet e shkaktuara nga kjo industri.

Shprehimisht standarti thotë: *”Qeveritë duhet që në mënyrë shumë të kujdesshme që zonat që janë pjesë e industrisë nxjerrëse të rikompensohen për dëmet që mund të shkaktohen nga kjo industri. Ky proces duhet të jetë i shpejtë, i besueshëm, transparent kompatibël me standartet e të Drejtave të Njeriut. Dështimi i dhënies së këtyre të ardhurave për pushtetin lokal do të krijoj mundësi për pakënaqësi nga qytetarët, pengim të projekteve të industrisë nxjerrëse apo edhe konflikte në raste të caktuara. Nga ana tjetër kjo do të rriste dhe shpenzimet e buxhetit, pasi do të kërkohen fonde më shumë për të mbështetur shtresat në nevojë nga komunitetet e prekura”.*

Sipas legjislacionit ndërkombëtar, të gjitha subjektet private të liçensuara apo ato që i'u është dhënë koncension, janë të detyruara të derdhin në favor të shtetit Rentën Minerare, një nga të ardhurat më të rëndësishme të buxhetit për vënde të cilat janë të pasura me burime natyrore .

Sipas legjislacionit shqiptar: *“ Çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrinë përgjegjëse për ekonominë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi dhe nën tokën e Republikës së Shqipërisë”.* Renta minerare llogaritet si një detyrim mujor i tatimpaguesit, në kohën kur ai shet produkte minerale. Në rastin e eksportit të produkteve minerale, qiraja paguhet në kohën kur bëhet deklarata e eksportit.

**Renta minerare** është e ardhura kryesore në buxhetin e shtetit nga industria nxjerrëse, kështu në vitin 2012 ajo përfaqësonte 85% të të ardhurave në buxhet nga industria nxjerrëse. Ndërsa në vlerë, për vitin 2012, renta e mbledhur ka qënë 7.15 miliard lek nga të cilat 6.4 miliard lek janë paguar nga sektori i hidrokarbureve dhe 0.75 miliard lek janë paguar nga sektori minerar.

Me ligjin Nr. 9975, 28/7/2008 “Për taksat Kombëtare”, pushteti vendor, ku zhvillohet aktiviteti i industrisë nxjerrëse duhet të përfitonte 25% të rentës minerare të mbledhur në buxhetin e shtetit. Por pushteti vendor, asnjëherë nuk ka marrë të plotë përfitimin e tij nga renta minerare, shpërndarja e saj ka është gjithmone kompetencë e Ministrisë së

Financave, e cila e zvogëlonte apo kufizonte përfitimin me udhëzime të ndryshme. Kjo ka bërë që komuniteti në vendet ku ushtrohet industria nxjerrëse të mos ketë përfituar asnjë gjë në lidhje me rentën minerare dhe kjo ka çuar në identifikimin e tyre si zonat më të varfëra dhe më pa perspektive zhvillimi në Republikën e Shqipërisë.

Kështu po t’iu referohemi burimeve të Ministrisë së Financave shohim se gjatë vitit 2011 nuk është bërë asnjë transfertë e rentës minerare të mbledhur nga industria nxjerrëse drejt pushtetit vendor ku ushtron aktivitetin kjo industri. Ndërsa, kemi një pamje tjetër për vitin 2012 kemi transferim të rentes minerare drejt njërive vendore ku ushtrohet aktiviteti i industrise nxjerrëse, vetem 41.7 milion lekë që është e barabartë me 2.3% të vlerës së rentës që parashikohet nga ligji për tu transferuar në bazë të ligjit ose një vlerë e pa konsiderueshme po të shohim se në vitin 2012 është mbledhur në buxhetin e shtetit

7.15 miliard lekë nga renta minerare. Qeveria qendrore nuk ka respektuar ligjin duke shpërndarë shumë pak nga fondi i rentës minerare, ç’ka do të thotë për komunitetin më pak investime, më pak zhvillim, më pak përmirësim të shërbimeve, më pak arsimim.

Në janar të vitit 2015, është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave se përfitimi i pushtetit vendor nga renta e mbledhur në buxhetin e shtetit do të jetë në masën 5% të shumës së gjeneruar nga shoqëritë që veprojnë në secilën njësi të qeverisjes vendore. Ky është një koncept i ri, i cili do të bëjë të mundur që Ministria e Financës të mbajë rekorde për kontributin e rentës për secilën njësi vendore më vehte, rekorde të cilat deri tani nuk janë mbajtur.

Me vendimin e Ministrisë së Financave është bërë dhe ndryshimi i vlerës së rentës, që duhet të paguajnë kompanitë e ndryshme, të cilat operojnë në fushën e mineraleve metalike, duke ulur detyrimin e tyre.

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm ilustron ndryshimet e bëra për vitin 2015.

Tab. 2

	Emërtimi i grupit	% Rentës 2014	% Rentës 2015
<b>Grupi i parë (I)</b>	<b>MINERALET METALIKE</b>		
	Mineralet e argjendit	10	6.7
	Mineralet e arit	10	6.7
	Mineralet e bakrit	6	4.0
	Mineralet e Kromit	6	4.0
	Mineralet e Nikelit (nikel-silikat)	6	4.0
	Mineralet e Hekurit (hekur-nikeli)	5	3.3
	Mineralet Plumbit	5	3.3
	Mineralet e Zinkut	7	4.7
	Gjithë mineralet e tjera metalike	4	2.7




Fig. 2 Burimi: Ministria e Financave



Sipas tabelës shohim se do të ketë një rënie të pagesës së rentës minerare, në tërësi, e cila përkthehet në më pak të ardhura për njësitë e qeverisjeve vendore ku zhvillohet industria nxjerrëse.

Tabela e mëposhtme tregon nivelin e rentës që mbledh Shqipëria në krahasim me vende të tjera të botës për njërin nga mineralet dhe pikërisht për bakrin. Nga kjo tabelë do të shohim se Shqipëria është në nivel të mesëm të marrjes së rentës.




Fig. 3 Burimi: Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Eshtë e rëndësishme të theksohet se, ndryshimet që janë bërë për nivelin e pagesës së rentës minerare dhe për vlerën që do ti transferohet pushtetit vendor nga fondi i rentës minerare, nuk ka pasur një proces transparent dhe konsultues me njësitë vendore apo me institucionet e transparencës siç është: Grupi Sektorial Ndër- Institucional i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

**Penalitetet tatimore** janë një e ardhur tjetër në buxhetin e shtetit për të cilin njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë dijeni se sa penalitete kanë subjektet mbasi nuk e kanë të sanksionuar me ligj që të përfitojnë nga kjo kategori pagesash. Penalitetet tatimore përfshijnë gjobat për ndotje mjedisi, penalitete për keqpërdorimin e burimeve natyrore, tejkalimin e licensës si afat kohor etj. Pra janë një kategori penalitetesh, të cilat ndikojnë drejdrejtë në dëmtimin e komunitetit dhe në zhvillimin e tij.

**Bonuset e nënshkrimit** janë pjesë e negociatave e marrëveshjeve për lejen e kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve. Edhe nga këto të ardhura njësitë e pushtetit vendor nuk kanë dijeni e nuk përfitojnë asgjë.

**Punësimi** është një nga përfitimet e tjera të rëndësishme për komunitetin ku ushtron aktivitetin e saj industria nxjerrëse. Po të bëjmë një krahasim të punësimit në vitin 2011 (janë rreth 8500 punëtorë) në vitin 2012 kemi të punësuar 7800 persona, pra kemi një rënie të punësimit në këtë sektor. Kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së investimit në kapital human, të trajnimeve dhe sigurisht edhe për shkak të keqfunksionimit të tregut të punës, ku një vend të konsiderueshëm, zë edhe punësimi në të zezë, i cili sjell pasoja tragjike deri në humbjen e jetës.

## VI. PËRFUNDIME

- Shqipëria ka ecur mirë në rrugën e bërjes transparente të industrisë nxjerrëse, por ajo duhet të vazhdojë që këto të ardhura ti shpërndajë edhe më shumë në drejtim të komuniteteve vendore. Ç'ka do të sillte zhvillim më të qëndrueshëm për komunitetet vendore duke krijuar kështu kushte më të favorshme për rritjen e nivelit ekonomik-social, arsimor, përmirësim të kushteve të mjedisit etj.
- Reforma Territoriale - Administrative që hyn në fuqi me mbarimin e zgjedhjeve për pushtetin vendor në qershor të 2015 nuk është një shans i mirë për të rritur të ardhurat që shkojnë në favor të qytetarëve që banojnë në zonat ku ka një industri nxjerrëse aktive, mbasi mungon një kuadër rregullator dhe mbikqyrës për këtë proces.
- Renta minerare që deri në vitin 2014 ishte planifikuar që të shkonte në favor të njësive vendore në masën 25 përqind, me ndryshimet e ligjit për Taksat Vendore në vitin 2015 ka zbritur në masën 5 përqind, ç'ka do të thotë që qeveritë vendore do të marrin më pak të ardhura nga shfrytëzimi i burimeve minerare dhe hidrokarbureve të tyre, më pak investime për këto zona, më pak plane zhvillimi dhe më pak mundësi për hapje vendesh pune.
- Pushteti Qëndror, në mënyrë arbitrare nuk e shpërndan rentën minerare sic parashikon ligji në masën e caktuar.
- Me vendim të Ministrisë së Financave, për vitin 2015 kemi ulje të vlerës së pagesave për rentën e mineraleve metalike cka do të thotë që zëri më i rëndësishëm i minerareve , ai që sjell më shumë të ardhura, do të paguaj tashmë më pak dhe në formë zinxhiri edhe pushteti vendor, komuniteti do të përfitojnë më pak të ardhura
- Procesi i ndryshimeve të vlerës së rentës minerare nuk është shoqëruar me transparencë duke mos u konsultuar me pushtetin local, qytetarët, shoqërinë civile, Grupin Ndërinstitucional për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse.
- 
- Nuk ka asnjë rregullator ligjor, i cili në përputhje me ndarjen e re administrative të Shqipërisë të krijoj mundësi që të ardhurat nga renta minerare të kalojnë për komunitetin ku zhvillohet industria nxjerrëse, mbasi zmadhimi administrative i njësive vendore, duke përfshirë në bashki edhe komunat, e bëjnë këtë pothuajse të pamundur që të mbikqyret dhe të zbatohet.

- Megjithëse ligji për industrinë nxjerrëse parashikon edhe disa taksa për shfrytëzimin e tokës, gjoba për keqmenaxhim të burimeve natyrore apo të tjera, nuk kemi asnjë të dhënë e cila të na bëjë të mundur që të shohim nëse kjo kategori të ardhurash në buxhetin e shtetit, përveç rentës, a i kalon një pjesë pushtetit vendor, të cilit i dëmtohet mjedisi, i dëmtohen burimet natyrore, i dëmtohet shëndeti i komunitetit etj.
- Në aspektin e punësimit, komuniteti ku ushtron aktivitetin e saj industria nxjerrëse, hasim një tendencë në ulje, e cila lidhet ngushtësisht me mungesën e ushtrimit të kontrollit nga organet kompetente.
- Marrëveshjet dhe kontratat midis qeverisë dhe kompanive që ushtrojnë aktivitetin në fushën e industrisë nxjerrëse nuk bëhen asnjëherë publike për komunitetin, i cili nuk ka dijeni në lidhje me afat kohore dhe përfitimet që merr ky komunitet, si psh. bonuset, apo sanksionet e vendosura për shkelje të lejes së shfrytëzimit, apo të ndotjes së mjedisit. Për këtë arsye bëhet më e vështirë marrja e informacioneve të nevojshme në lidhje me transparencën në sektorin e hidrokarbureve dhe minerare.

## VII. REKOMANDIME

Për plotësimin e standarteve që kërkon Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, Shqipërisë si një vend anëtar i saj, i duhet ende shumë punë dhe vullnet. Për këtë arsye mbështetur edhe në analizën e mësipërme Ne rekomandojmë:

- Më shumë dialog midis pushtetit qendror dhe pushtetit lokal, në lidhje me vendimarrjet për politikën e zhvillimeve të komunitetit, ku ushtron aktivitet industria nxjerrëse.
- Më shumë transparencë dhe më shumë pjesëmarrje të shoqërisë civile në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.
- Pjesë e kësaj transparence dhe dialogu të jetë publikimi i kontratave konkensionare dhe marrëveshjeve të lidhura midis kompanive që ushtrojnë aktivitetin në industrinë nxjerrëse dhe qeverisë Shqiptare.
- Hartimi sa më i shpejtë i procedurave për shpërndarjen e fondeve të transferuara nga pushteti qendror në pushtetin lokal, në mënyrë që efica e rentës minerare për zhvillimin e komunitetit të jetë qartësisht e dallueshme.
- Hapja e një debati midis pushtetit lokal dhe qendror për të zgjeruar spektrin e përfitimit financiar të komunitetit ku zhvillohet industria nxjerrëse, duke kërkuar që të përfitojnë të ardhura edhe nga mbledhja e gjobave që ju vendosen kompanive që veprojnë në fushën e industrisë nxjerrëse dhe nga bonuset e përcaktuara në marrëveshjet, njësoj si renta minerare.
- Duhet të gjëndet një mekanizëm ligjor, i cili të detyroj pushtetin qendror që të bëjë transferimin e rentës minerare cdo vit në përputhje me % e parashikuar në ligj.

## VIII. BIBLIOGRAFI

AlbEITI –[www.albeiti.gov.al](http://www.albeiti.gov.al)

EITI –[www.eiti.org](http://www.eiti.org)

Ministria e Financave –[www.mof.gov.al](http://www.mof.gov.al)

Drejtoria e Doganave –[www.dogana.gov.al](http://www.dogana.gov.al)

Natural Resource Governance Institute – [www.nrgi.org](http://www.nrgi.org)

Ministria e Pushtetit Lokal –[www.reformaterritoriale.al](http://www.reformaterritoriale.al)

INSTAT

Ministria e Energjisë dhe Industrisë